

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 3, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹dhe neni 41, paragrafi (1) dhe nënparagrafi 6 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në lidhje me nenin 42, paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizue nr.ark. 01-3632/1 të datës 22.8.2025 dhe Njoftimin për ndryshimin e strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO ShPK Strugë PA1 nr. 02-134 të datës 18.5.2026, në përputhje me Konkluzionin e Këshillit nr. ark. 02-2386/6 të datës 10.6.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 22-të të mbajtur më 10.6.2026, miratoi:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON – RADIO ShPK Strugë, si më poshtë vijon:

- për tërheqjen e personit fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr. " [REDAKTUAR] " nr. [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 37.52% në kapitalin bazë dhe për transferimin e pjesës së tij të personi fizik [REDAKTUAR] me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr. " [REDAKTUAR] " nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

2. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive JON - RADIO ShPK Strugë është e detyruar, pas ndryshimit të kryer, cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, t'i paraqesë Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele statusin aktual të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive JON – RADIO ShPK Strugë është e detyruar të paraqesë ndryshimin e strukturës pronësore nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 ditësh nga data e miratimit të këtij Vendimi. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e caktuar, ky Vendim do të anulohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) JON – RADIO ShPK Strugë, në përputhje me nenin 41, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV-së) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin në strukturë pronësore (PA1 nr. 02-134 të datës 18.5.2026), njoftoi Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e saj për të zbatuar ndryshim në strukturën pronësore të ShTR JON – RADIO ShPK Strugë.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës pronësore (PA1 nr. 02-134 të datës 18.5.2026) nga ShTR JON – RADIO ShPK Strugë u përcaktua si i plotë dhe i rregullt, përkatësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore.

Agjencia, me qëllim që të shqyrtojë nëse ndryshimet e propozuara në strukturën pronësore të ShTR JON – RADIO ShPK Strugë do të krijojnë përqendrim të palejuar mediatik, përkatësisht nëse ato janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LShMAAV-së, përmes Sistemit të Shpërndarjes së Internetit të Regjistrin Qendror të RMV-së, ofroi informacion mbi subjektet e lidhura (persona të autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) - gjendjen aktuale, nr.0820-50/150020260203187, nr.0820-50/150020260203200, nr.0820-50/150020260203139 dhe nr.0820-

¹Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

50/150020260203222 të gjitha më datë 19.5.2026, nga e cila është e qartë se personi fizik [REDAKTUAR] shfaqet si: pronar dhe drejtues i Shoqërisë Tregtare GOZ SERVIS ShPKNJ P Gostivar, me aktivitet prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 43.240 - punë të tjera ndërtimi dhe instalimi (ky person juridik nuk shfaqet si themelues i shoqërive tregtare); pronar i ShTR JON - RADIO ShPK Strugë (transmetuesi nuk shfaqet si themelues i shoqërive tregtare); drejtues i Shoqërisë për Tregti, Prodhim, Ndërtim, Transport, Turizëm dhe Shërbime GIV MONT ShPKNJ P eksport-import, Gostivar me veprimtari prioritare/kodi kryesor i të ardhurave është 41.000 - Ndërtimi i pallateve banesore dhe jo-banesore (ky person juridik nuk shfaqet si themelues i shoqërive tregtare); person i autorizuar i degës së Shoqërisë Tregtare GOZ SERVIS ShPKNJ P Gostivar dhe person i autorizuar i degës së ShTR JON - RADIO ShPK Strugë.

Plotësuese, Agjencia ka kryer kontroll edhe në Regjistrin e pronarëve përfitues të mbajtur nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku është pajisur me dokument Statusi Aktual për personin fizik - pronar përfitues, nr. 2007-50/150020260203282 datë 19.5.2026, për [REDAKTUAR], nga i cili mund të konkludohet se ky person është i regjistruar si pronar përfitues i: Shoqërisë Tregtare GOZ SERVIS ShPKNJ P Gostivar dhe Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO ShPK Strugë.

Pas ndryshimit të kryer në strukturën pronësore, pronari i vetëm i ShTR JON – RADIO ShPK Strugë do të jetë personi fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr. " [REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR].

ShTR JON – RADIO ShPK Strugë është e detyruar të zbatojë ndryshimin në strukturën pronësore nga pika 1 e këtij Vendimi në Regjistrin Qendror të RMV-së, në afat prej 90 ditësh nga data e miratimit të këtij Vendimi. Nëse ndryshimi nuk zbatohet në afatin e caktuar, ky Vendim do të anulohet.

Duke pasur parasysh se Agjencia konstatoi se zbatimi i ndryshimit në strukturën pronësore të ShTR JON – RADIO ShPK Strugë nuk krijon përqendrim të palejuar mediatik sipas kuptimit të LShMAAV, përkatësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të paraqitur për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR JON – RADIO ShPK Strugë PA1 nr. 02-134 të datës 18.5.2026, Këshilli i Agjencisë miratoi vendim si në dispozitive.

Nr. 02-134
11.6.2026
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse është i pakënaqur nga vendimi, ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh pas miratimit të vendimit të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Përktheu: Antoneta Shabani